



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 112-6021 /2025

Klinë, datë 27/02/2025

Duke u bazuar në nenin 13, 14 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, botuar në Gazetën Zyrtare, nr. 28/2008 publikuar më dt.04.06.2008, nenin 91 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Klinës të miratuar më datën 31.03.2010, me propozimin e DSHPE, duke u bazuar në Raportin e Stacionit Policor në Klinë, nr.08-052-4682/2025 të datës 12.02.2025, Kryetari i Komunës së Klinës, **merr këtë;**

V E N D I M

Për formimin e komisionit për identifikimin e objekteve dhe vendeve
qe paraqesin rrezikshmëri për qytetaret

1. **FORMOHET**, komisioni komunal për identifikimin e vendeve dhe objekteve në territorin e Komunës së Klinës, qe paraqesin rrezikshmëri për qytetaret, si dhe vlerësimin e gjendjes së tyre.

Përbërja e komisionit është, **siç vijon:**

- 1.1. Visar Bojaj, kryesues;
 - 1.2. Burim Hoti, anëtarë;
 - 1.3. Arianit Nrecaj, anëtarë;
 - 1.4. Haki Bajraktari, si dhe;
 - 1.5. Adem Sejdiu, anëtarë.
2. Komisioni merr për obligim qe të beje dhe vlerësimin e gjendjes se rrezikshmërisë të vendeve dhe objekteve të paraqitura sipas Raportit të stacionit policor në Klinë, si dhe identifikimin e objekteve dhe vendeve tjera në territorin e Komunës së Klinës qe paraqesin rrezikshmëri për qytetaret.
 3. Komisioni për punën e vet harton raport dhe jep rekomandime lidhur më gjendjen e vendeve dhe objekteve më rrezikshmëri më të cilin njoftohet kryetari i komunës.
 4. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Të njoftohen:

- Të përmendurit;
- Ekzekutivi;
- Zyra e Informimit, si dhe;
- Arkivi.

Kryetari
Zenun Elezaj

